

Megjithatë, element të shëndetit dhe të të drejtave seksuale dhe riprodhuese gjenden, gjithashtu, në objektivat e tjera, duke treguar praninë e tyre në të gjitha fushat e zhvillimit të qëndrueshëm duke qenë çështje kritike për suksesin e përgjithshëm të Programit. Për më tepër, shumë nga objektivat e Programit janë thelbësore për krijimin e një mjedisi në të cilin shëndeti seksual dhe riprodhues dhe të drejtat mund të realizohen.

Kjo përfshin, për shembull, si më poshtë :

Objektivi 4. Sigurimi i arsimimit gjithëpërfshirës të barabartë dhe cilësor, që promovon mundësitë e të mësuarit, gjatë gjithë jetës, për të gjitha grupet.

- 4.1 Deri në vitin 2030, t'iu garantohet të gjitha vajzave dhe djemve arsimit fillor dhe i mesëm falas, i barabartë dhe cilësor, që çon në rezultate të rëndësishme dhe efektive të të mësuarit.
- 4.5 Deri në vitin 2030, të zhduken pabarazitë gjinore në arsim për të siguruar qasje të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe të trajnimit profesional, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, popullatën e stigmatizuar dhe fëmijët në nevojë.
- 4.7 Deri në vitin 2030, t'u garantohet të gjithë nxënësve përvetësimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, duke përfshirë, ndër të tjera, edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm, mënyrën e jetesës së qëndrueshme, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, nxitjen e kulturës së paqes dhe jo dhunës, qytetarinë globale dhe vlerësimin e diversitetit kulturor, gjithashtu edhe promovimin e kontributit të kulturës ndaj zhvillimit të qëndrueshëm.

Objektivi 6. Sigurimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe kanalizimeve për të gjithë.

Synimi:

- 6.2 Deri në vitin 2030, të jetë arritur qasje në kanalizim dhe higjienë të përshtatshme për të gjithë me kanalizimet përkatëse të ujërave të zeza, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe, sidomos atyre në nevojë.

Objektivi 8. Nxitja e rritjes ekonomike të qëndrueshme, dhe gjithëpërfshirëse, punësim i plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.

- 8.5 Deri në vitin 2030, të arrihet punësim i plotë dhe produktiv dhe të sigurohet punë e denjë për të gjithë gratë dhe burrat, duke përfshirë të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe pagesë të barabartë për punë me vlerë të barabartë.

Objektivi 10. Reduktimi i pabarazisë brenda dhe midis shteteve.

- 10.2 Deri në vitin 2030, të fuqizohet dhe promovohet përfshirja sociale, ekonomike dhe politike për të gjithë, pavarësisht moshës, gjinisë, paaftësisë, racës, kombësisë, origjinës, besimit fetar, gjendjes ekonomike apo ndonjë statusi tjetër.
- 10.3 Të sigurohen mundësi të barabarta për të reduktuar pabarazitë në rezultate, duke zhdukur ligjet, politikat, praktikat diskriminuese dhe duke promovuar legjislacionin, politikat dhe veprimet e duhura në këtë drejtim.
- 10.4 Të miratohen politika, sidomos politika fiskale, të mbrojtjes sociale, të pagave dhe të arrihet barazi më e madhe në mënyrë progresive.

Objektivi 16. Të nxiten shoqëritë paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, të sigurohet qasje në drejtësi për të gjithë dhe të ndërtohen institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

- 16.1 Të reduktohen ndjeshëm të gjitha format e dhunës dhe përqindja e vdekshmërisë si pasojë e tyre.
- 16.2 Të zhduken shfrytëzimi, trafikimi, dhe të gjitha format e dhunës dhe torturave ndaj fëmijëve.
- 16.3 Të promovohet sundimi i ligjit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të garantohet qasje e barabartë në drejtësi për të gjithë.



Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd 26 , H.6 , Ap.1, Tirane, Albania
Email: info@acpd-al.org • Telefon: + 355 4 2251 475 • http://www.acpd-al.org

Axhenda 2030



OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM





OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM



 **ANGAZHIMI YNË PËR REALIZIMIN E TYRE**

Programi për zhvillim të qëndrueshëm, 2030” i miratuar nga 193 shtete anëtare të **Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-së)**, përmban një deklaratë, **17 objektiva** për zhvillim të qëndrueshëm dhe 169 tregues.

Ky program është i veçantë, sepse kërkon veprim nga të gjitha vendet, qofshin ato të varfëra apo të pasura. Aty theksohet se zhdukja e varfërisë duhet të ecë paralelisht me një plan për rritjen ekonomike në të cilin trajtohen një varg nevojash sociale përfshirë arsimin, shëndetësinë, mbrojtjen sociale dhe punësimin, duke trajtuar edhe ndryshimin klimatik dhe mbrojtjen e mjedisit. Në të mbulohen edhe çështje të tilla si **pabarazia, infrastruktura, energjia, konsumi, biodiversiteti, oqeanet dhe industrializimi.**

Axhenda 2030 përfshin shumë tregues në lidhje me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave, shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese të cilat shkojnë përtej angazhimeve të OZHM-ve (Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit).

Tregues të veçantë në lidhje me shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese.

Ka disa tregues, që lidhen drejtpërdrejt me shëndetin seksual dhe riprodhues si dhe disa, që i referohen aspekteve të veçanta të SHSR, duke demonstruar natyrën ndërsektoriale dhe rëndësinë e SHSR për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm për të gjithë.



3 SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE



OJEKTIVI 3 Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe.

TREGUESIT

3.1 Deri në vitin 2030, të reduktohet niveli i vdekshmërisë amtare në botë në më pak se 70 raste për 100,000 lindje të gjalla.

3.3 Deri në vitin 2030, të zhduket epidemia e AIDS-it, tuberkulozit, malaries dhe sëmundjeve tropikale të neglizhuara dhe të luftohen hepatiti dhe sëmundjet e tjera infektive.

3.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje universale në shërbimet shëndetësore të shëndetit seksual dhe riprodhues, duke përfshirë planifikimin familjar, informimin dhe edukimin, si dhe integrimin e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare.

3.8 Të arrihet mbulim shëndetësor universal, duke përfshirë mbrojtjen financiare ndaj riskut, qasje në shërbime shëndetësore cilësore dhe qasje në mjekime/barna bazë dhe vaksina të sigurta, të efektshme, cilësore dhe të përballueshme për të gjithë.

5 BARAZI GJINORE



OJEKTIVI 5 Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

TREGUESIT

5.1 Zhdukja kudo e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe vajzave .

5.2 Zhdukja e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave në mjedise publike dhe private, duke përfshirë trafikimin, shfrytëzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit.

5.3 Zhdukja e të gjitha praktikave të dëmshme, të tilla si martesat e hershme dhe me detyrim të fëmijëve dhe gjymtimi gjenital femëror.

5.6 Sigurimi i qasjes universale në shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese siç është rënë dakord, në përputhje me “Programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin” dhe Platformën për Veprim të Pekinit”, si dhe dokumentet e rezultateve të konferencave të rishikimit të tyre.